



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVË
REPUBLICA KOSOVA
OPŠTINA E ORAHOVCIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Orahovac

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

-IV- Nr. l prot. 1835 Më Dt. 05.07.2024
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raport i DKA – së në fund të vitit mësimor 2023/2024

Përgjatë nëntë muajve të vitit mësimor 2023/2024 në kuadër të DKA-së u realizuan një varg aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin edhe në Planet Vjetore të Punës për të dy vitet kalendarike. Këto aktivitete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të shkruara në këtë raport, sipas periudhave, siç vijon:

Periudha e tremujorit të parë (shtator – nëntor)

- Pas riparimeve të fundit e punimeve në projektin e efijencës, në objektin e shkollës “Rilindja” në Çifllak është bërë edhe riparimi i kulmit të ndërtesës. Në objektin e shkollës në Sapniq ka përfunduar ndarja fizike e 3 klasëve dhe janë krijuar kushte e mundësi që nxënësit e kësaj shkolle të mbajnë mësim vetëm në një ndërrim dhe kësisoji do të mundësohet kursimi gati përgjysmë i shpenzimit të energjisë për ngrohje dhe për nevoja të tjera;
- Kemi përfunduar furnizimin me pelet në të gjitha shkollat të cilat e kanë në përdorim këtë lëndë djegëse për ngrohje;



- Morëm dy njoftime të shumëpritura, të cilat kanë të bëjnë me nënshkrimin e kontratës për furnizimin e çerdheve të reja me inventar dhe nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e objektit të ri të shkollës në Pastasel;
- Ka vazhduar dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve arsimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në;



- Mbajtëm një takim me drejtorët e shkollave, kryetarët e KDSH-ve dhe koordinatorët e cilësisë. Realizuam disa vizita në shkolla për t'u siguruar për mbarëvajtjen e procesit mësimor;
- Në objektin e Shfmu “Dëshmorët e Zatriqit” është punuar në ndarjen fizike të 3 dhomave të mësimit, në mënyrë që të krijohen mundësi reale për mbajtjen e mësimit vetëm në një ndërrim;
- Në objektin e Shfmu “Dëshmorët e Lirisë” në Pataqan të Poshtëm kemi filluar të bëjmë ndarjen fizike të 3 klasave, dhe me këtë veprim mundësohet që nxënësit të vijojnë mësimin vetëm në një ndërrim;
- Javën e fundit të nëntorit përfundim projektin e efijencës së energjisë në Shfmu “Faik Konica” në Celinë;



Periudha e tremujorit të dytë (dhjetor – shkurt)

- Mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës Matematike, në të cilën garuan nxënësit e klasave 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 nga të gjitha shkollat e komunës sonë;



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo Komuna
Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtorija për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Datë/Datum/Date:	30.11.2023
Referenc-ë	04/ 1441
Për/Za/To:	Shoqata e Matematikanëve të Kosovës
CC:	
Përmes/Preko/Through:	DKA
Nga/Od/From:	Avni Morina, Drejtor
Subjekti/Predmet/Subject:	Lista e nxënësve për pjesëmarrje në OMK-2023, Rahovec

Nr.	Institucioni arsimor	Emri Mbiemri	Klasa
1.	SHFMU "Heronjtë e Kosovës"	Hysrete Berisha	VII
2.	SHFMU "Bajram Curri"	Art Hoti	VII
1.	SHFMU "Sapniqi"	Erjola Morina	VIII
2.	SHFMU "Bajram Curri"	Elisa Duraku	VIII
1.	SHFMU "Hamëz Thaçi"	Leonit Thaçi	IX
2.	SHFMU "Heronjtë e Kosovës"	Yllza Lezi	IX
1.	SHML "Ukshin Hoti"	Orlenta Dina	X
2.	SHML "12 Maji"	Sahit Hoti	X
1.	SHML "Ukshin Hoti"	Leart Shala	XI
2.	SHML "Xhelal Hajda-Toni"	Odesa Rama	XI
1.	SHML "Xhelal Hajda-Toni"	Erëza Mullaabazi	XII
2.	SHML "12 Maji"	Bleart Morina	XII

- Për nder të festave të nëntorit, bashkë me nxënësit e shkollave të mesme mbajtëm një orë letrare në bibliotekën e qytetit;
- Përruam projektin "Ndikimi i rinisë në mjedis" të cilin e realizuan nxënësit e Klubit Ekologjik të SHML "12 Maji" në bashkëpunim me Caritasin Zvicëran dhe organizatën "Ec ma ndryshe";
- Punimet në projektet e ndërtimit të objekteve të reja të shkollave kanë vazhduar në Shfmu "Katër Dëshmorët" dhe punime përfundimtare ka pasur në Shfmu "Tre Dëshmorët", e cila u bë e gatshme dhe u përrua në muajin dhjetor;
- Në fillim të janarit përgatitëm planin përfundimtar (final) të prokurimit për projektet kapitale, për furnizime dhe për mallra dhe shërbime;
- Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e parë, përfundoi më 12 janar, 2024 dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 24 janar 2024;

- Në bashkëpunim me DKRS, me pjesëmarrjen e të gjitha shkollave, organizuam dhe mbajtëm Orën e Madhe Letrare në kuadër të manifestimeve “Flaka e Janarit”;
- Më 31 janar 2024 u mbajt trajnimi i fundit i mentorëve të 25 SHFMU-ve nga organizata Kosova Makers League, me ç`rast u bë edhe pranimi i 100 robotëve edukativ (nga 4 për secilën nga 25 shkollat), të cilët u financuan nga komuna jonë;



- Organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës së Fizikës, në të cilën morën pjesë nxënësit më të mirë të klasave 9, 10, 11, 12;



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
 Drejtorija për Arsim-Odeljenje za Obrazovanje-Department of Education

Datë/Datum/Date:	13.02.2024
Referencë	04/1562
Nga/Od/From:	Drejtori i DKA-së , Avni Morina
Subjekti/Predmet/Subject:	Fituesit e Garës Komunale të Olimpiadës së Fizikës



Pas vlerësimit të bërë nga komisioni vlerësues, nxënësit fitues, që do ta përfaqësojnë komunën tonë në Garën Shtetërore në Fizikë, janë:

Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbledhja	Klasa
1	SHFMU "Bajram Curri"	Sidrit Duraku	IX
2	SHML "Xhelal Hajda"	Gresa Raba	X
3	SHML "Xhelal Hajda"	Vesa Miftari	XI
4	SHML "Xhelal Hajda"	Vlera Orllati	XII

- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë ka vazhduar ndërtimi i mureve të brendshme, ndërsa në Ratkoc ka vazhduar puna në montimin e xhamave të dritareve;



- Organizuar aktivitete me nxënës në nderim të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, siç ishin vizitat monumenteve kulturo-historike dhe në vendlënit e dëshmorëve e gjithashtu edhe programe festive në shkolla dhe në programin qendror festiv;
- Më 24 shkurt, 4 nxënësit fitues të Garës Komunale në Fizikë i dërguam në Prishtinë për të marrë pjesë në Garën Shtetërore. Nga 4 nxënësit fitues të Garës Komunale në Fizikë që morën pjesë në Garën Shtetërore, dy prej tyre treguan sukses të lakmueshëm;
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, është punuar në sallën e edukatës fizike të Shfmu “Bekim Sylka”;



Periudha e tremujorit të tretë (mars – maj)

- Në Gexhë kemi përruar projektin e efijencës së energjisë, ndërsa në Çiflak filluan punimet në rregullimin e fushës sportive në oborrin e shkollës;



Projekti i efijencës së energjisë në objektin e Shfmu "Skënder Kastrati" në Gexhë

- Në kuadër të projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme është punuar në rregullimin e nyjeve sanitare në objektet e shkollave në Drenoc, Senoc dhe në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici";
- Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (SHPIK) për fillimin e zbatimit të Projektit të Kodimit në Fushën e Teknologjisë Informative;
-
- Ka filluar furnizimi me inventar i 3 çerdheve të reja. Fillimisht, furnizime u bënë në Çerdhen për Fëmijë në Krushë të Madhe dhe më pas vazhdoi furnizimi për Çerdhen e Fëmijëve në Ratkoc;
- Më 31 mars u përrua fusha e re sportive në oborrin e SHFMU "31 MARS" në fshatin Guri i Kuq;
- Përgatitëm planin e shpërndarjes së librave nëpër biblioteka shkollore dhe planin e shpërndarjes së pajisjeve laboratorike dhe mjeteve të konkretizimit nëpër shkolla;
- Pas pushimit pranveror, sipas kalendarit vjetor të MASHTI-t, rifilloi procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e dytë të gjysmëvjetorit të dytë dhe gjithashtu, në bashkëpunim

me policinë e komunitetit u mbajtën ligjërata për nxënësit në gjithsej 4 shkolla. Në 2 shkolla të tjera u mbajtën ligjërata edhe nga përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit.

- Kanë vazhduar vizitat sistematike mjekësore për fëmijët (nxënësit e klasave të para dhe të pesta;
- Nga bashkatdhetari ynë Agron Berisha pranuar donacion një sasi të konsiderueshme të pajisjeve të teknologjisë informative dedikuar shkollave të komunës sonë;
- Vazhduam furnizimin me pajisjeve laboratorike dhe mjeteve të konkretizimit nëpër shkolla Mjete konkretizimi dhe laboratorike nga kimia, fizika, matematika, biologjia, gjeografia e historia janë ndarë në gjithsej 8 shkolla;





Pajisje laboratorike dhe mjete konkretizimi në 8 shkolla

- Kemi bërë përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave komunale të diturisë, të cilat u mbajtën në fund të këtij muaji;
- Hapëm konkursin për regjistrimin e fëmijëve nëpër cerdhe dhe konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës;

Periudha e fundit (qershor – 15 korrik)

- Patëm shënimin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, me një manifestim në Qendrën e Kulturës “Mensur Zyberaj” së bashku me DKRS dhe me SHPG “Hareja”;
- Më 3 qershor 2024 filluan së funksionuari 3 çerdhet e reja, në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc;





- Kemi bërë përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave komunale të diturisë për klasat e pesta në të gjitha shkollat, të cilat u zhvilluan me sukses;
- Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, ka përfunduar puna në drenazhimin përreth objektit të SHML “Xhelal Hajda –Toni”;
- Po ashtu, në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, kanë filluar riparimet e brendshme në dy objekte shkollore, në SHFMU “Gëzim Hamza-Piktori” në qytet dhe në SHFMU “Rudolf Walther”, paralelja e ndarë në Dobidol.





Riparime në SHFMU “Gëzim Hamza-Piktori”

- Ndërkohë, në kuadër të kontratës për ndërtimin e rrethojave të oborreve shkollore, ka përfunduar ndërtimi i rrethojës së oborrit të shkollës në Dobidol dhe pritet të fillojnë punimet në ndërtimin e rrethojës së oborrit të Shkollës “Tre Dëshmorët”;



Rrethoja e oborrit të shkollës në Dobidol

- Në shkollat e reja në ndërtim, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë është punuar në kulmin e ndërtesës dhe në suvatimin e mureve të brendshme, ndërsa në Ratkoc ka përfunduar suvatimi dhe punimet kanë vazhduar në izolimin e jashtëm të objektit;
- Kanë filluar punimet paraprake për përgatitjen e terrenit dhe rrethimin e punishtës në vendin ku është planifikuar të ndërtohet objekti i ri i Shkollës “Milaim Krasniqi” në Pastasel;
- Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e dytë për klasat 1 deri 8 përfundoi më 24 qershor, ndërkohë, më 25 dhe 28 qershor u zhvillua Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta, në dy pjesë sipas lëndëve mësimore dhe në këtë test morën pjesë 547 nxënës të klasave të nënta, të sistemuar në 4 qendra;
- Në garat e robotikës të mbajtura në nivel vendi, në të cilat morën pjesë 400 shkolla, shkollat e komunës tonë kanë korrur suksese dhe prej 25 shkollave pjesëmarrëse në këto gara, 7 prej tyre janë kualifikuar që të marrin pjesë në Finalen e Madhe, e cila u mbajt më 30 qershor dhe njëra nga shkollat, përkatësisht SHFMU “Sulejman Vokshi” zuri vendin e nëntë në nivel vendi në Finalen e Madhe të Garës së Robotikës;
- Kemi bërë përgatitjet për mbajtjen e Provimit të Maturës për klasat e 12-a dhe ky provim u mbajt në 3 qendra, ku morën pjesë 285 maturantë, prej të cilëve pragon e kalueshmërisë prej 40% e kaluan 220 maturantë, ose e shprehur në përqindje 77,19%, ndërsa 65 prej tyre, ose 22,81 %, nuk e kaluan këtë prag. Prandaj, pjesa e mbetur do të përfshihen në afatin e dytë të Provimit të Maturës; Niveli i kalueshmërisë në Provimin e Maturës, këtë vit ka shënuar rritje për 10% në krahasim me vitin e kaluar kur kalueshmëria ishte 67,19%.



Avni Morina
Avni Morina
 Drejtor i DKA-së